



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____. _____. 2025

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: **Operatorit Ekonomik “FLED” SHPK** me adresë: Lagjia “Havaleas”, rruga Ura e kozares, Kuçove, godine private 1-kateshe, Nr.307, Havalehas, Kuçove, me nipt **K 17621104 C**

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Tipi i Kontratës: Punë

Procedura e prokurimit: Proçedurë e hapur e thjeshtuar

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-67141-10-29-2025**

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 27.11.2025

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: *Buletini Nr. 75 datë 02 Dhjetor 2025*

“Ndërtimi i këmbëve të urave dhe speronave të urave tip beli mbi përroin “Lugaj” në fshatin Labinot Katund, njësia administrative Labinot Mal”, me fond limit 8,926,449 (tetëmilion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e nëntë) lekë (pa tvsh), vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. “FLED” SHPK me Nipt: K 17621104 C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **8.047.091,30** (tetëmilion e dyzet e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një presje tridhjetë) **lekë (pa tvsh)**.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “BAJRAMI N.” sh.p.k. me Nipt: K 02727202 O

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **8.162.755,15** (tetëmilion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë presje pesëmbdhjetë) **lekë (pa tvsh)**.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “Colombo LTD” SH.P.K. me Nipt: M 31420052 T

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **7.716.579,75** (shtatëmilion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e pesë) **lekë (pa tvsh)**.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar operatorët ekonomik si me poshte:

1. BAJRAMI N

Në përmbushje të kriterit 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim keni deklaruar se drejtues teknik i punimeve në objekt do të jetë ing. F. M.

Ing. F. M. e keni deklaruar si drejtues Teknik të punimeve edhe në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion dhe shtesë anësore 3 kate e shkollës 9 – vjeçare “Naim Frashëri”, lagjja “Kongresi Elbasanit”, procedure, në të cilën jeni shpallur fitues dhe në datë 05.11.2025 keni nënshkruar kontratën me autoritetin kontraktor, Bashkia Elbasan.

Në këtë procedurë keni deklaruar se ing. F. M. nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, dhe se në rast se shpallet fitues do të jetë i angazhuar vetëm në këtë kontratë.

Në UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, përcaktohet se: Për projekte me vlerë të plotë të preventivuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

Sa më sipër, ing. F. M. nuk mund të jetë i angazhuar në kontratën objekt prokurimi, duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Në nenin 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të LPP përcaktohet:

1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi

4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj.

Sa më sipër, oferta juaj refuzohet.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

2. COLOMBO LTD

Në përmbushje të kriterit 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim, keni paraqitur si pune të ngjashme kontratën e bashkepunimit (sipermarrje punimesh) neshkruar në datë 10.10.2023 midis subjektit tuaj (sipermaaresi) dhe shoqërive "Euro Holding" shpk dhe "Abi Cons" shpk. (porositesi).

Shoqëritë "Euro Holding" shpk dhe "Abi Cons" shpk për punimet, për të cilat kanë nënshkruar kontratën e lartepemendur me subjektin tuaj, kanë nënshkruar kontratën e punës me Autoritetin Rrugor Shqiptar si autoritet kontraktor, pas kryerjes së procedurave të prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se kishte mangësi si më poshtë:

1. Mungon miratimi zyrtar i Autoritetit Rrugor Shqiptar si autoritet kontraktor.
2. Formulari i vlerësimit sipas shtojcës 9 nuk është leshuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar si autoritet kontraktor, por nga kontraktuesit, Shoqëritë "Euro Holding" shpk dhe "Abi Cons" shpk. Gjithashtu edhe akti i kolaudimit dhe situacioni perfundimtar, që shoqëron këtë formular duhet të ishte nënshkruar nga Autoritetit Rrugor Shqiptar si autoritet kontraktor.
3. Nuk keni paraqitur Proces verbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Ne pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta, kapaciteti teknik është kerkuar:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: -Kontratë punimesh, -Situacionin përfundimtar, -Akt-kolaudimin, -Çertifikatën e marrjes në dorëzim, -Faturat tatimore për Situacionin përfundimtar.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne nenin 126 të LPP “Nënkontraktimi” përcaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit u kërkon ofertuesve të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e kontratës, që ata mendojnë të nënkontraktojnë të palët e treta, si dhe nënkontraktorin e propozuar.

2. Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e kontratës dhe nuk duhet të tejkalojë 50 përqind të vlerës së përgjithshme të kontratës.

3. Autoriteti ose enti kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

4. Dispozitat e këtij neni nuk prekin përgjegjësitë kryesore të operatorit ekonomik ndaj autoritetit ose entit kontraktor, për të cilin nënkontraktorët mbeten palë e tretë, kundrejt marrëdhënies kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe nënkontraktorëve të tij dhe duke e lënë operatorin ekonomik kryesor përgjegjës për zbatimin e të gjithë kontratës, pavarësisht se një pjesë e saj zbatohet nga nënkontraktorët.

5. Autoriteti ose enti kontraktor lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti te nënkontraktori për furnizimet, shërbimet ose punët që i ka ofruar kontraktorit kryesor. Në çdo rast, kontraktori kryesor duhet të vihet në dijeni dhe të japë miratimin me shkrim për këto pagesa. Rregullat që lidhen me këtë mënyrë pagese përcaktohen në dokumentet e tenderit.

Sa mesiper, nuk përmbushni kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 dhe oferta juaj refuzohet.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **"FLED" SHPK me Nipt: K17621104C**, me adrese Lagjia "Havaleas", rruga Ura e kozares, Kuçove, godine private 1-kateshe, Nr.307, Havalehas, Kuçove, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **8.047.091,30** (tetëmilion e dyzet e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një presje tridhjetë) **lekë (pa tvsh)**, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Elbasan**, Drejtoria e Prokurimeve Publike, rruga "Qemal Stafa", sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr. i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
ZV.KRYETARI
Asim Sula